

VENDIM
Nr. 65, datë 3.2.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MARRËVESHJET
JASHTËGJYQËSORE TË RIORGANIZIMIT TË PËRSHPEJTUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 4, të nenit 79, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për marrëveshjet jashtëgjyqësore të riorganizimit të përshpejtuar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Falimentimit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE
**PËR MARRËVESHJET JASHTËGJYQËSORE TË RIORGANIZIMIT TË
PËRSHPEJTUAR**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për lidhjen e marrëveshjeve jashtëgjyqësore të riorganizimit të përshpejtuar ndërmjet debitorit, që është subjekt i ligjit për falimentimin, dhe dy ose më shumë kreditorëve, në kushtet kur debitori ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese.

Neni 2

Përkufizime

1. “Situata e pashmangshme e paaftësisë paguese” ka të njëjtin kuptim sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 123, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

2. “Marrëveshja jashtëgjyqësore e riorganizimit të përshpejtuar” (në vijim, marrëveshja e riorganizimit) është një marrëveshje ndërmjet debitorit dhe dy ose më shumë kreditorëve, jashtë gjykatës, përpara fillimit të procedurave të falimentimit, që ka si qëllim të krijojë kushtet për debitorin për vijimin e veprimtarisë tregtare nëpërmjet zbatimit të një plani masash të përcaktuara në marrëveshje dhe të mbikëqyrur nga kreditorët.

3. “Marrëveshja e pezullimit” është një marrëveshje e lidhur ndërmjet debitorit dhe kreditorëve, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 6, të kësaj rregulloreje.

Neni 3

Mirëbesimi gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e marrëveshjes

1. Palët kanë detyrimin për të dhënë informacione të sakta dhe të plota gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e marrëveshjes.

2. Debitori duhet t'u ofrojë të gjithë kreditorëve pjesëmarrës në negociata informacionin e plotë në lidhje me:

- a) veprimtarinë financiare të debitorit dhe rrethanat që shkaktuan paaftësinë paguese;
- b) një listë të kreditorëve dhe detyrimet përkatëse të secilit prej tyre;
- c) parashikimet financiare, përfshirë llogarinë e humbjeve e të fitimeve të parashikuara, si dhe raportin e pasqyrave financiare gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes;
- ç) të dhënat për shumat, pasuritë, si dhe aktivet e debitorit që mund të përdoren për vijimin e veprimtarisë tregtare, si dhe përmbushjen e detyrimeve të kreditorëve, sipas marrëveshjes së riorganizimit;
- d) çdo informacion tjetër që kreditorët e çmojnë të nevojshëm për vlerësimin e gjendjes financiare të debitorit dhe të aftësisë së tij paguese për të zbatuar marrëveshjen e propozuar të riorganizimit.

Neni 4

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Palët janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e çdo të dhëne ose informacioni që jepet nga debitori ose nga kreditorët gjatë ose pas bisedimeve për hartimin e marrëveshjes së riorganizimit, pavarësisht nëse është lidhur apo jo marrëveshja, si dhe të mos përdorin ose të shpërndajnë informacionin e përfutur gjatë këtyre bisedimeve pas përfundimit të tyre.

2. Pavarësisht nga parashikimet e pikës 1, të këtij neni, palët nuk janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave ose informacioneve të përfuturara gjatë zhvillimit të bisedimeve në rastet e mëposhtme:

- a) zotëruesi i informacionit jep shprehimisht pëlqimin e tij;
- b) informacioni kërkohet nga organe që e kanë të përcaktuar me ligj të drejtën për të disponuar një informacion të tillë;
- c) vetë pala pjesëmarrëse në bisedime e përdor këtë informacion për të kërkuar përmbushjen e një të drejte apo interesi të saj të ligjshëm kundrejt palës tjetër.

3. Pala që shkel detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave sipas parashikimeve të këtij neni përgjigjet për dëmin e shkaktuar.

KREU II

PROCEDURA STANDARDE E NEGOCIMIT

Neni 5

Bisedimet shumëpalëshe

1. Procedura standarde e negociimit fillon me paraqitjen e kërkesës për zhvillimin e bisedimeve nga debitori ose nga më shumë se një kreditor. Kërkesa mund të paraqitet në çdo formë që dokumenton dërgimin e saj palës tjetër. Pala së cilës i drejtohet kërkesa mund të shprehë pëlqimin e saj për fillimin e procedurave standarde në çdo formë që dokumenton dërgimin e saj palës tjetër.

2. Palët përcaktojnë datën dhe vendin për fillimin e procedurave.

3. Kreditorë të tjerë mund t'i bashkohen kësaj procedure derisa të mos jetë nënshkruar marrëveshja ndërmjet palëve.

Neni 6

Pezullimi i pretendimeve të kreditorëve

1. Me nënshkrimin e marrëveshjes së pezullimit, debitori:

- a) ndalohet të ndërmarrë veprime të administrimit të jashtëzakonshëm, me përjashtim të rasteve kur veprimet çmohen të domosdoshme për ecurinë e aktivitetit të shoqërisë;
 - b) ndalohet të tjetërsojë kuotat ose aksionet e shoqërisë;
 - c) detyrohet të informojë kreditorët në lidhje me ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë.
2. Kryerja nga debitori I veprimeve në kundërshtim me parashikimet e kësaj dispozite i lind të drejtën kreditorit të ndërpresë procedurën e negociimit.

Neni 7

Koordinimi i kreditorëve

1. Në rast se në procedurën e negociimit marrin pjesë më shumë se 10 (dhjetë) kreditorë, ata kanë të drejtë të caktojnë një komitet kreditorësh për t'i përfaqësuar gjatë procedurave të negociimit me debitorin.
2. Komiteti i kreditorëve përbëhet nga të paktën 3 (tre) kreditorë. Mbledhja për zgjedhjen e komitetit të kreditorëve zhvillohet me pjesëmarrjen e 75 (shtatëdhjetë e pesë) % të kreditorëve që marrin pjesë në negociata. Anëtarët e komitetit të kreditorëve zgjidhen me shumicë të thjeshtë të votave të kreditorëve pjesëmarrës në mbledhje.
3. Marrëveshja e riorganizimit votohet e nënshkruhet nga secili kreditor pavarësisht vendimmarrjes së komitetit të kreditorëve gjatë procedurave të negociimit.

KREU III

MARRËVESHJA DHE EFEKTET E SAJ

Neni 8

Marrëveshja e riorganizimit

1. Marrëveshja e riorganizimit duhet të bëhet me akt noterial, ndryshe është e pavlefshme.
2. Marrëveshja e riorganizimit është e detyrueshme vetëm për ata kreditorë që kanë votuar për miratimin e saj dhe janë palë të kësaj marrëveshjeje.
3. Në rastet kur nuk ndiqet procedura standarde e negociimit, sipas kreut II, të këtij vendimi, debitori mund të garantojë ekzekutimin e detyrimeve, nëpërmjet çdo mjeti që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, deri në momentin e përfundimit të negociimeve.

Neni 9

Përbajtja e marrëveshjes

1. Marrëveshja e riorganizimit duhet të përfshijë ristrukturimin e detyrimeve të debitorit në një nga mënyrat e mëposhtme:
 - a) duke shtyrë maturimin e borxhit apo datën e ripagesës së detyrimit;
 - b) duke ulur shumën e pagesës që detyrohet;
 - c) duke zëvendësuar detyrimet ekzistuese të prapambetura me detyrime të reja me një datë më të vonë maturimi ose me një detyrim më të vogël;
 - ç) duke siguruar burime të reja financimi;
 - d) një kombinim i mënyrave të mësipërme.
2. Marrëveshja e riorganizimit mund të përfshijë edhe çdo masë tjetër të përshtatshme, që palët bien dakord, e cila ka si qëllim ristrukturimin e detyrimeve të debitorit.
3. Përbajtja e marrëveshjes së riorganizimit duhet të jetë e tillë që të sigurojë, për aq sa është e mundur, bazuar në kritere ekonomike objektive, mundësinë e biznesit për të vijuar veprimtarinë për një periudhë afatmesme, jo më pak se 6 (gjashtë) muaj.

Neni 10

Fuqia e marrëveshjes

1. Kushtet dhe afatet e marrëveshjes së riorganizimit të nënshkuara në përputhje me nenet 7, 8 dhe 9, të kësaj rregulloreje, janë të zbatueshme edhe në rast se debitori kalon në paaftësi paguese dhe fillojnë procedurat e falimentimit, në përputhje me ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

2. Do të konsiderohen të vlefshme në kuadër të procedurës së falimentimit edhe çdo pagesë, garanci apo veprim juridik i kryer në zbatim të parashikimeve të marrëveshjes së riorganizimit.

Neni 11

Trajtimi i burimeve të reja të financimit

1. Në rast se në marrëveshjen e riorganizimit palët kanë parashikuar sigurimin e burimeve të reja të financimit nga debitori, fondet e siguruara prej tij do të përdoren vetëm për ekzekutimin e marrëveshjes.

2. Në rastin e një gjendjeje të mëpasshme të paaftësisë paguese të debitorit, fondet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, do të konsiderohen pjesë e masës së falimentimit, ndaj të cilës mund të parashtrijnë pretendime të gjithë kreditorët, sipas parashikimeve të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.